



Pranimar / Dorezuar Prilijeno / Prodato Received / Delivery	08.02.23	viti god year	
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSTHCK	1556/2023		115



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1148/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1148/2022 të datës 12.12.2022, e parashtruar përmes përfaqësuesit të autorizuar avokatit

përmes postës së shpejt(mikmik), me numër dërgese 6857943936 të datës 01.12.2022, për ankuesen kundër organit të punësimit Komunës së Obiliqit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 08.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

Përfundim Procedimi administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr.1148/2022, të datës 12.12.2022, të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja ka aplikuar në konkursin me numër referencë RN00009663, me emrin e grupit „ Specialist të Shkencave Shoqërorë” për pozitën: “Zyrtar për bibliotekë 4”, në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport të shpallur nga Komuna e Obiliqit, sipas njoftimit të datës 03.08.2022 për aplikim nga data 25.08.2022 deri me datë 02.09.2022, në të cilën procedurë ankuesja ka qenë e përfshirë në të gjitha fazat e rekrutimit.

Me datë 28.10.2022 ankuesja është njoftuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore pranë Komunës së Obiliqit për vlerësimin përfundimtar të Komisionit të Pranimit për konkursin me numër reference RN00009663 për pozitën “Zyrtar për bibliotekë 4”, dhe kundër mos përzgjedhjes si kandidate fituese për këtë pozitë ankuesja me datë 29.10.2022 ka parashtruar ankesë tek Komisioni i Pranimit me pretendime ankimore se konkursi ka pasur shkelje procedurale në të gjitha fazat e rekrutimit, mos informim me kohë të rezultateve të testit me shkrim dhe favorizim të kandidates së përzgjedhur, dhe ka propozuar që ti mundësohet qasja për të parë testin me shkrim dhe procesverbalin, të pezullohet

kjo përzgjedhje si dhe të rishpallet konkursi në fjalë, tutje Komisioni i Pranimit me datë 04.11.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër protokoll XII/291 me të cilën i ka refuzuar ankesën ankueses dhe ka lënë në fuqi shpalljen e rezultateve të vlerësimit përfundimtar me Nr.XII/282 të datës 28.10.2022

Ankuesja e pa kënaqur me Vendimin XII/291 të Komisionit të Pranimit në Shërbimin Civil pranë Komunës së Obiliqit të datës 04.11.2022, ka parashtruar ankesë me datë 01.12.2022 përmes postës së shpejt (mik-mik), me numër dërgese 6857943936, të pranuar dhe regjistruar me datën 12.12.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime ankimore se procedura e rekrutimit për pranim në pozitë: "Zyrtar për bibliotek 4" me numër reference RN00009663, ka pasur shkelje ligjore në të gjitha fazat e rekrutimit deri tek vlerësimi përfundimtarë duke filluar nga mos informimi me kohë i rezultateve të testit me shkrim, vlerësimi jo i drejtë i jetëshkrimit duke mos njohur përvojën e punës dhe trajnimet, si dhe vlerësimin nga intervista me gojë për të cilin thekson se është bërë në mënyrë të pa anshme dhe jo meritore, si dhe i propozon Këshillit që të bëhet ndryshimi i vlerësimit i Komisionit për Pranim në Shërbimin Civil pranë Komunës së Obiliqit dhe të përzgjidhet kandidatë e suksesshme për pozitën në konkursin e lartë cekur ose të anulohet konkursi në fjalë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.12.2022, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses tek Komuna e Obiliqit. Ndërsa Këshilli me datë 28.12.2022 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Obiliqit të protokolluar me numër: 8528/2022 me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën A.nr.1148/2022 të parashtruar nga ankuesja Zelushe Kelmendi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 12.12.2022; Autorizimin e ankueses Z.K për përfaqësim të datës 21.11.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës drejtuar Udhëheqësit i Personelit pranë Komunës së Obiliqit të protokolluar me numër 8174/2022 të datës 16.12.2022; Përgjigje në ankesë të lëshuar nga Udhëheqësi i Personelit pranë Komunës së Obiliqit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokoll 8528/2022 të datës 28.12.2022; Njoftimin e Konkursit me numër reference RN00009663 specialistë të Shkencave Shoqërore në pozitën "Zyrtar për bibliotekë 4" në Drejtorin për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Obiliqit; Lista e aplikantëve të aprovuar dhe refuzuar për konkursin me numër reference RN00009663; Vendim për themelimin e Komisionit për Pranim të lëshuar nga Kryetari i Komunës së Obiliqit me numër protokoll 1227 të datës 08.09.2022 ; Akt emërim i anëtarit të komisionit për pranim E.H me numër II/06 të datës 10.04.2018 të lëshuar nga Komuna e Obiliqit; Akt emërimi i anëtares të komisionit për pranim L.H me numër II/16 të datës 03.01.2013 të lëshuar nga Komuna e Obiliqit; Akt emërim i anëtarit të komisionit për pranim F.G me numër II/09 të datës 23.08.2017 të lëshuar nga Komuna e Obiliqit; Akt emërim i anëtarit të komisionit për pranim R.Z me numër II/06 të datës 24.01.2014 të lëshuar nga Komuna e Obiliqit; Vendimin e Komunës së Obiliqit për emërimin e ekspertit të jashtëm V.B në komisionin për pranim në shërbimin civil me numër II/1230 të datës 12.09.2022; Njoftimin e listës së kandidatëve të aprovuar të lëshuar nga Komuna e Obiliqit me numër XII/236 të datës 14.09.2022; Renditja përfundimtare e kandidatëve për konkursin me numër referencë RN00009663 me datën 28.10.2022; Njoftim për intervistë me gojë të dërguar me e-mail nga A.M për ankuesen Z.K të datës 24.10.2022; Rezultatet e vlerësimit përfundimtarë me numër protokoll XII/2822 të datës 28.10.2022; Ankesën e ankueses drejtuar

Komisionit të Pranimit për konkursin me numër reference RN00009663 e datës 29.10.2022; Vendimin e Komisionit për Pranim në Shërbimin Civil me numër XII/291 të datës 04.11.2022; Njoftim për test me shkrim të dërguar me e-mail nga A.M për ankuesen të datës 10.06.2022; Aplikacioni i kandidatës L.TH së bashku me përgatitjen profesionale dhe atë të përvojës së punës të datës 25.08.2022; Letërnjoftimin e kandidatës L.TH.G; Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë me PN.Nr./Kr.Br 20558/2022 të datës 16.08.2022 për kandidaten L.TH.G; Diplomën e lëshuar nga Kolegji i Menaxhmentit Internacional në Podujevë në Programin Biznes dhe Menaxhment me specializim të datës 28.07.2021 për kandidaten L.TH.G; Diplomën e lëshuar nga Grupi për Liritë dhe të drejtat e fëmijëve për kandidaten L.TH; Vërtetim i lëshuar nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Podujevës me numër protokolli 130/21 të datës 10.06.2021 për kandidaten L.Th; Certifikatë Finalizimi e lëshuar me datën 12.06.2021; Certifikatën e lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Organizata "Codex" në muajin Maj 2019 për kandidaten L.TH; Raportin mbi verifikimin e dokumenteve të humbura e lëshuar nga Policia e Kosovës me datën 11.08.2022; Aplikacioni i ankueses Z.K së bashku me përgatitjen profesionale dhe atë të përvojës së punës të datës 26.08.2022; Certifikatë e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë me PN.NR/KR.Br.19881/22 të datës 11.08.2022 për ankuesen Letërnjoftimin e ankueses Letër referencë të lëshuar nga "ak Ascom Group"; Certifikatën e lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për ankuesen me Nr.311/2022 të datës 07.06.2012; Certifikatën e lëshuar nga Organizata Islamike Botërore e Ndihmave nga Arabia Saudite- Zyra e Kosovës për ankuesen Z.K me datë 02.04.2005; Certifikatën e lëshuar nga Organizata Islamike Botërore e Ndihmave nga Arabia Saudite- Zyra e Kosovës për ankuesen Z.K me datë 20.11.2004; Certifikatën e lëshuar nga "Nansen Fredssenter" për ankuesen Z.K; Certifikatën e lëshuar nga "Kryqi i Kuq i Kosovës" për ankuesen Z.K me datë 03-05.04.2015; Certifikatën e lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për ankuesen Z.K e muajit Dhjetor 2014; Certifikatën e lëshuar nga "OSCE" për ankuesen Z.K me datë 21.11.2014; Certifikatën e lëshuar nga "OSCE" për ankuesen Z.K me datë 23.10.2014; Dëftesë e lëshuar nga Shtëpia e Shpresës-Mulloshëve për ankuesen Z.K me numër protokolli 1830/2012 me datë 28.06.2012; Certifikatën e lëshuar nga Agjencia për Zhvillim Rajonal-Qendër dhe "Eured" për ankuesen Z.K në muajin Nëntor 2012; Certifikatën e lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për ankuesen Z.K me datën 18.12.2015; Certifikatën e lëshuar nga ORT-ja Botërore, përfaqësia në Kosovë për ankuesen Z.K me datë 30.06.2002; Certifikatën e pjesëmarrjes e lëshuar nga "KCSF" për ankuesen Z.K me datë 30.10.2005; Certifikatën e pjesëmarrjes e lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për ankuesen Z.K me datë 01-03.06.2016; Certifikatën e pjesëmarrjes e lëshuar nga "KCSF" për ankuesen Z.K me datë 19.05.2016; Certifikatë pjesëmarrje e lëshuar nga USAID për ankuesen Z.K; Certifikatën e pjesëmarrjes e lëshuar nga UNDP për ankuesen Z.K; Certifikatën e lëshuar nga Gizi Projekt për ankuesen Z.K në muajin Janar 2020; Certifikatë e lëshuar nga OSCE për ankuesen Z.K me datë 20.07.2019; Certifikatë e lëshuar nga OSCE për ankuesen Z.K me datë 19-21.04.2019; Certifikatë e lëshuar nga "Youth Academy Forum" për ankuesen Z.K me datë 23-26.09.2019; Certifikatë e lëshuar nga Partner Kosova Center for Conflict Menagment për ankuesen Z.K me datë 26-28.12.2019; Certifikatë e lëshuar nga OSCE për ankuesen Z.K me datën 15.12.2020; Certifikatë e lëshuar nga OSCE për ankuesen Z.K me datë 12-14.10.2021; Certifikatë e lëshuar nga OSCE për ankuesen Z.K me datë 29.07-28.10.2021; Diplomën e lëshuar nga Kolegji "AAB-Programi Përkujdesje dhe Mirëqenie e Fëmijëve më numër 068/18 të datës 19.01.2018 për ankuesen Z.K;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, konstatoi që të përfundohet procedimi administrativ i filluar me ankesën e ankueses me numër A.nr.1148/2022 të datës 12.12.2022, *sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë së Komuna e Obiliqit sipas njoftimit të datës 03.08.2022, ka shpallur konkursin, me emrin e grupit „Specialistë të Shkencave Shoqërore“ me numër të referencës RN00009663 për vendin e lirë të punës “Zyrtar për Bibliotekë 4”, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja. Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 25.08.2022 deri me datë 02.09.2022 ndërsa bazuar në listën e ngushtë të datës 14.09.2022 rezulton se numri i kandidateve aplikues ka qenë gjithsej tridhjetë e shtatë (37), ndërsa njëzetë (20) prej tyre janë përfshirë në listën e ngushtë përkatësisht janë vlerësuar që kanë plotësuar kërkesat e veçanta dhe të përgjithshme formale të përcaktuara me konkurs.

Bazuar në listën përfundimtare të përzgjedhjes të Komisionit të Pranimi i themeluar me Vendimin me numër protokollit XII/1227 të datës 08.09.2022, rezulton se ankuesja nuk është vlerësuar me pikë të mjaftueshme për t’u shpallur kandidate fituese rrjedhimisht ankuesja me date 28.10.2022 është njoftuar për renditjen përfundimtare të kandidatëve dhe është vlerësuar gjithsej me 67.4 te pikëve të përgjithshme, kështu që mbi bazën e këtij raporti, Njësia e Burimeve Njerëzore me datë 28.10.2022 ka shpallur Njoftimin mbi rezultatet e vlerësimit përfundimtar me numër protokollit XII/282 lidhur me përfundimin e procedurës së rekrutimit për grupin *Specialistë të Shkencave Shoqërore* për pozitën “Zyrtar për Bibliotekë 4”, dhe raportin e SIMBNJ për renditjen përfundimtare të kandidatëve duke listuar kandidatët lidhur me pikët e arritura në të gjitha fazat e testimit deri tek totali ku si kandidate me më shumë pikë të arritura dhe njëkohësisht kandidate të suksesshme ka përzgjedhur znj. Lule Thaqi Gërbeshi, me gjithsej 75.6 pikët e përgjithshme.

Ankuesja e pakënaqur me vlerësimin e Komisionit të Pranimi, brenda afatit ligjor parashtron ankesë të brendshme të Komisioni i Pranimi i cili me Vendimin me numër protokollit XII/291 të datës 04.11.2022 ka refuzuar ankesën e ankueses të datës 29.10.2022 si të pabazuar. Kundër këtij vendimi ankuesja ushtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljeve të parimeve të Ligjit Nr.06-114 për Zyrtarët Publikë si dhe akteve nënligjore për pranim, shkelje të dispozitave ligjore lidhur me aplikimin e gabuar të procedurës së vlerësimit nga intervista më gojë dhe shkelje të dispozitave materiale gjegjësisht ajo pretendon se nuk është njoftuar me kohë për rezultatin e testit me shkrim, dhe se nuk i është bërë vlerësimi i drejtë në intervistën me gojë, biografi(CV), përvojën e punës dhe trajnimeve duke kërkuar që ti bëhet rivlerësimi dhe të përzgjidhet si kandidate e suksesshme në këtë pozitë..

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me këtë procedure te rekrutimit ka vendosur sipas ankesës së kandidates A. Graiqevci-Plakolli, ku me Vendimin A.nr.970/2022 të datës 28.12.2022 ka refuzuar ankesën e ankueses duke lenë ne fuqi Listën përfundimtare të vlerësimit si dhe Njoftimin me numër protokollit XII/282 të datës 28.10.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore mbi rezultatet e vlerësimit përfundimtar për grupin *Specialistë të Shkencave Shoqërore* për pozitën “Zyrtar për Bibliotekë 4”.

Andaj, bazuar në gjendjen faktike si me lartë, dhe duke marrë parasysh së objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.1148/2022 ka të bëjë me procedurën e rekrutimit për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritorë me Vendimin A.nr. 970/2022 të datës 28.12.2022, respektivisht ka refuzuar ankesën e ankueses dhe ka lenë në fuqi Njoftimin me numër protokollit XII/282 të datës 28.10.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore te Komunës së Obiliqit mbi rezultatet e vlerësimit përfundimtar për grupin *Specialistë të Shkencave Shoqërore* për pozitën “Zyrtar për Bibliotekë 4”, Kolegji i Këshillit konstaton së objekti i ankesës A.nr.1148/2022 është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje, dhe si rrjedhojë Kolegji në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme

Administrative më të cilat është përcaktuar se: *Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot, vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.1148/202 të datës 12.12.2022.*

Theksuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.1148/2022.

Zyle Millaku GOJNOVCI

*Procesmbajtëse*

Malsore GASHI BAJRAKTARI

*Kryetare e Kolegjit*

**Vendimi i dorëzohet:**

- Përfaqësuesit
- Kryetarit të Komunës së Obiliqit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Obiliqit dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;